



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

PROCES VERBAL

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për muajin Gusht 2025

Data 29.08.2025 ora 13:00.

Mbledhja zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat.

Rendi i dites:

- 1.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 25.07.2025, si dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.
- 2.Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Korrik 2025.
- 3.Projekt vendim për ndryshimin e VKB nr.84 datë 23.12.2024 "Miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe PBA përfundimtarë 2025-2027, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës.
- 4.Projekt vendim për dhënien në përdorim me afat deri në 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 5.3 ha "Për aerogjenerator (stacionet, objektet përkatëse etj) dhe 5.258 km rrugë për tu lidhur me sipërfaqen që do të jepet në përdorim në ekonominë pyjore Gjader Mnelë"
- 5.Projekt vendim për dhënien në përdorim me afat deri në 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 3 ha "Për aerogjenerator (stacionet, objektet përkatëse etj) dhe 4.063 km rrugë për tu lidhur me sipërfaqen që do të jepet në përdorim në ekonominë pyjore Gjader Mnelë"
- 6.Projekt vendim për dhënien në përdorim me afat deri në 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 5 ha "Për aerogjenerator (stacionet, objektet përkatëse etj) dhe 3.909 km rrugë për tu lidhur me sipërfaqen që do të jepet në përdorim, 6.709 km linja transmetimi të energjisë elektrike në ekonominë pyjore Gjader Mnelë"
- 7.Projekt vendim për dhënie pëlqimi "Për përcaktimin e vendit të groposjes së kafshëve të ngordhura në një pjesë të pasurisë nr.675, Zk nr.1100, në fshatin Barbullush me sipërfaqe 500m2,sipas plan rilevimit bashkëlidhur".
- 8.Projekt vendim për rishikimin e Vkb nr.36 datë 26.06.2025 "Mbi dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjes të shtetasit Pjetër Mirash Gjoni i dëmtuar nga zjarri me datë 16.05.2025, banorë i Bashkisë Vau Dejës".



9.Projekt propozim për ndryshimin e emërimit të një segmenti të një rruge në lagjen Mllojë, Bashkia Vau Dejës, me emrin e propozuar “Zef Tanushi”, lagja Mllojë, Bashkia Vau Dejës.

10.Projekt vendim për miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis Nj.Q.V dhe K.M të R.Sh për rritjen e kapaciteteve të Q.V, akademia e trajnimit të Njësisë të vetëqeverisjes vendore të Shqipërisë (TALGA)

11.Të ndryshme

Në mbledhje ishte i pranishëm një grup interesi - përfaqësuesi i shoqatës “Tomorrow Starts Today” dhe presidenti i F.C BASANIA z.Ermir Shimaj. Votimet do bëhen të hapura.

Mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejes u zhvillua me datë 29.08.2025 ora 13.00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat. Fillimisht u bë apeli i këshilltarëve që ishin prezent në sallë, nga ana e sekretarit të Këshillit Bashkiak, Z.Ardian Çelepija.Të pranishëm në sallë ishin 20 këshilltarë,(Pjeter Lleshi, Florin Tanushi,Mark Bisha,Franga Kola,Kastriot Shkjau,Leonora Prenga,Neki Kapllanaj,Majlinda Ndreca,Arsen Mehmeti,Roberto Trushi,Frano Prenga,Albina Livadhi,Ervis Shimaj,Rita Preçi,Ermir Tahiri,Ornela Lleshi,Besmir Kapaj,Gjon Marku,Meliha Zyberaj,Edona Molla), korum i mjaftueshëm dhe i nevojshëm për të zhvilluar mbledhjen e këshillit.

Fjalën për të filluar mbledhjen e mori Z.Ervis Shimaj -kryetar i këshillit bashkiak i cili lexoi rendin e ditës dhe pyeti këshilltarët nëse ishin dakort me rendin e ditës.Rendi i ditës u miratua me 20 vota Pro.Këshilltarët që votuan pro: Këshilltarët që votuan pro:(Pjeter Lleshi, Florin Tanushi,Mark Bisha,Franga Kola,Kastriot Shkjau,Leonora Prenga,Neki Kapllanaj,Majlinda Ndreca,Arsen Mehmeti,Roberto Trushi,Frano Prenga,Albina Livadhi,Ervis Shimaj,Rita Preçi,Ermir Tahiri,Ornela Lleshi,Besmir Kapaj,Gjon Marku,Meliha Zyberaj,Edona Molla).Pas miratimit të rendit të ditës, z.Pjeter Lleshi largohet nga salla e mbledhjes pa dhënë ndonjë arsye.Në sallë mbesin prezent 19 këshilltarë.

Z.Ervis Shimaj lexon piken e parë të rendit të ditës:

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 25.07.2025 si dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.

U pyeten këshilltarët nëse ishin dakort me procesverbalin e mbledhjes së datës 25.07.2025 nga Z.Ervis Shimaj.Këshilltarët nuk kishin pyetje dhe të gjithë shprehen dakortësi për miratimin e tij.



Këshilltarët që votuan pro: (Florin Tanushi, Mark Bisha, Franga Kola, Kastriot Shkjau, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Majlinda Ndreca, Arsen Mehmeti, Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi, Ervis Shimaj, Rita Preçi, Ermir Tahiri, Ornella Lleshi, Besmir Kapaj, Gjon Marku, Meliha Zyberaj, Edona Molla).

Z. Ervis Shimaj lexon piken e dytë të rendit të ditës:

Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Korrik 2025

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj. Elidona Lisi -perfaqesuese e zyres se ndihmes ekonomike, e cila relaton lidhur me projekt vendimin e paraqitur. Ajo shprehet se projekt vendimi është hartuar bazuar ne ligjin nr. 139, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar; Ligjin nr. 57/2019, datë 18.7.2019, "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë"; VKM-në nr. 597, datë 4.9.2019, "Për Përcaktimin e Procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndhmën Ekonomike", të ndryshuar, Si dhe bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 02, datë 27.01.2025, "Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të ndihmës ekonomike për vitin 2025"; Shkresën e Prefekturës së Qarkut Shkodër për shprehje ligjshmërie nr. 106/1 prot, datë 11.02.2025.

Ajo shprehet se projekt vendimi propozon qe: Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin Korrik 2025 , familje 132, me 422.741 lekë, me 5.98% e fondit total. Në total për Bashkinë Vau Dejës, për Muajin Kprrik 2025 janë shpallur fitues, 943 familje, me fond 7.046.392 lekë, nga ku 6% e këtij fondi është 422.783 lekë.

Z. Ervis Shimaj spjegon se komisioni i K. Bashkiak ka propozuar miratimin e projekt vendimit.

Z. Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z. Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 18 vota Pro zero kundër dhe 1(një) votë abstenim – Z. Gjon Marku, abstenim pa spjegim. Këshilltarët që votuan **Pro** piken e dytë të rendit të ditës: (Florin Tanushi, Mark Bisha, Franga Kola, Kastriot Shkjau, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Majlinda Ndreca, Arsen



Mehmeti,Roberto Trushi,Frano Prenga,Albina Livadhi,Ervis Shimaj,Rita Preçi,Ermir Tahiri,Ornela Lleshi,Besmir Kapaj,Meliha Zyberaj,Edona Molla).

Z.Ervis Shimaj lexon piken e tretë të rendit të ditës:

Projekt vendim për ndryshimin e VKB nr.84 datë 23.12.2024 "Miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe PBA përfundimtarë 2025-2027, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës.

Z.Ervis Shimaj sqaron këshilltarët se për këtë projekt vendim është realizuar dëgjese publike me datë 21.08.2025 dhe se të pranishmit kanë shprehur dakortesi për projekt vendimin, dhe për të relatuar për projekt vendimin fton Znj.Armena Zagani – përgjegjëse e zyrës financë buxhetit pranë Bashkisë Vau Dejës, e cila relatton për këshilltarët se duke u nisur nga shkresa Nr. 4120 Prot datë 24.07.2025 e Drejtorisë së Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë, Sportit dhe Zhvillimit të Turizmit, Sektori i Arsimit, Rinisë dhe Sportit drejtuar Sektorit të Financës me lëndë "Kërkesë për Rishikim Buxheti viti 2025, viti 2026" zyra e financë buxhetit është angazhuar për të vënë në dispozicion vlerën e kërkuar për realizimin e projektit duke bërë rishpërndarje buxheti ndërmjet programeve buxhetore. Po ashtu në buxhetin e vitit 2025- 2026 do të bëhet shtesë e zërit me emërtimin "Rikonstruksion fusha e futbollit Bushat" Kjo shkresë ka ardhur në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Vau-Dejës dhe FSHS-së, ku FSHF-ja është e angazhuar të bashkëfinancojë 50% të vlerës së investimit total prej 36,259,842.14 ALL. Rishpërndarja e buxhetit do të bëhet sipas tabelës nr 1 dhe tabelës nr 2 përkatësisht për vitin 2025 dhe 2026 pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi, për të mundësuar bashkëfinancimin nga ana e Bashkisë në vlerën 18,129,921.07 ALL. Kemi prekur zëra buxheti të investimeve që nuk janë pjesë e projekteve prioritare për vitin 2025, gjithashtu është bërë shtesë projekti për zërin "Rikonstruksion fusha e futbollit Bushat"

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 19 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim Këshilltarët që votuan **Pro** piken e tretë të rendit të ditës:(Florin Tanushi,Mark Bisha,Franga Kola,Kastriot Shkja,Leonora Prenga,Neki Kapllanaj,Majlinda Ndreca,Arsen Mehmeti,Roberto Trushi,Frano Prenga,Albina Livadhi,Ervis Shimaj,Rita Preçi,Ermir Tahiri,Ornela Lleshi,Besmir Kapaj,Gjon Marku,Meliha Zyberaj,Edona Molla).

Z.Ervis Shimaj lexon piken e katërt të rendit të ditës:



Projekt vendim për dhënie në përdorim me afat deri në 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 5.3 ha "Për aerogjenerator (stacionet, objektet përkatëse etj) dhe 5.258 km rrugë për tu lidhur me sipërfaqen që do të jepet në përdorim në ekonominë pyjore Gjader Mnelë"

Z.Ervis Shimaj sqaron këshilltarët se për këtë projekt vendim është realizuar dëgjese publike me datë 27.08.2025 në fshatin Mnel e Madhe dhe se të pranishmit kanë shprehur dakortesi për projekt vendimin, dhe për të raportuar për projekt vendimin fton Z.Zeqir Ujka - përgjegjës i zyrës pyjeve Bashkia Vau Dejës, i cili raporton për këshilltarët se bazuar në Ligjin nr 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 9 pika 1.2 c, neni 54 pika e/l, neni 18, është kompetencë e Këshillit të Bashkisë miratimi i dhënies në përdorim të tretëve sipas legjislacionit në fuqi, të pasurive shtetërore në pronësi apo administrim të Bashkisë.

-Sipërfaqja që do të jepet në përdorim është 5.3 ha "për aerogjeneratorë (stacionet,objektet përkatëse etj) dhe 5.258 km rrugë për tu lidhur me sipërfaqen që do të jepet në përdorim,Në funksion të sipërfaqes që merret në përdorim, sipas VKM nr.559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore"

Tëardhurat vjetore që përfiton Bashkia nga miratimi i projekt vendimeve është:

Për projekt vendimin e mësipërm të ardhurat vjetore janë : 1,124,199 (Njëmilion e njëqind e njezete e kater mijë e njëqind e nëntë dhjetë e nëntë) lekë në vit.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Z.Gjon Marku- shprehet se do i votoj kundra projekt vendimet e pikës4,5 dhe 6 sepse nuk shikoj transparencë në dëgjuesen publike dhe hartat që keni paraqitur.

Lidhur me transparencën e dëgjuesës publike sqarohet nga Z.Ervis Shimaj se njoftimi është bërë brenda afateve ligjore dhe është bërë publik së bashku me projekt vendimet, se ku e shikon mungesën e transparencës, vetëm ju e dini ndërsa lidhur me hartat, sqaron Z.Zeqir Ujka, i cili thekson se bashkëngjitur projekt vendimit keni edhe hartat shpjeguese të cilat janë mjaft të qarta.

Këshilltarët e tjerë nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 17 vota Pro.1(një) votë kundër(Gjon Marku) dhe 1(një) votë abstenim(Florin Tanushi) Këshilltarët që votuan **Pro** piken e katërt të rendit të ditës:(Mark Bisha,Franga Kola,Kastriot Shkja,Leonora Prenga,Neki Kapllanaj,Majlinda Ndreca,Arsen Mehmeti,Roberto



Trushi,Frano Prenga,Albina Livadhi,Ervis Shimaj,Rita Preçi,Ermir Tahiri,Ornela Lleshi,Besmir Kapaj, „Meliha Zyberaj,Edona Molla).

Z.Ervis Shimaj lexon piken e pestë të rendit të ditës:

Projekt vendim për dhënien në përdorim me afat deri në 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 3 ha “Për aerogenerator (stacionet, objektet përkatëse etj) dhe 4.063 km rrugë për tu lidhur me sipërfaqen që do të jepet në përdorim në ekonominë pyjore Gjader Mnelë”

Z.Ervis Shimaj sqaron këshilltarët se edhe për këtë projekt vendim është realizuar dëgjese publike me datë 27.08.2025 në fshatin Mnel e Madhe dhe se të pranishmit kanë shprehur dakortesi për projekt vendimin, dhe per te relatuar per projekt vendimin fton Z.Zeqir Ujka - pergjegjes i zyres pyjeve Bashkia Vau Dejës, i cili relaton për këshilltarët se bazuar në Ligjin nr 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 9 pika 1.2 c, neni 54 pika e/l, neni 18, është kompetencë e Këshillit të Bashkisë miratimi i dhënies në përdorim të tretëve sipas legjislacionit në fuqi, të pasurive shtetërore në pronësi apo administrim të Bashkisë.

-Sipërfaqja që do të jepet në përdorim është 3 ha "për aerogeneratorë(stacionet,objektet përkatëse etj) dhe 4.063 km rrugë për tu lidhur me sipërfaqen qe do jepet në përdorim, Në funksion të sipërfaqes që merret në përdorim, sipas VKM nr.559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore" VKM nr 467 datë 31.07.2025 shtojca 3.

Tëardhurat vjetore që përfiton Bashkia nga miratimi i projekt vendimeve është:

Për projekt vendimin e mësipërm të ardhurat vjetore janë : 581,260 (Peseqind tetedhjetë e nje mijë e dyqind e gjashtë dhjetë) lekë në vit.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 17 vota Pro.1(një) votë kundër(Gjon Marku) dhe 1(një) votë abstenim(Florin Tanushi) Këshilltarët që votuan **Pro** piken e pestë të rendit të ditës:(Mark Bisha,Franga Kola,Kastriot Shkjau,Leonora Prenga,Neki Kapllanaj,Majlinda Ndreca,Arsen Mehmeti,Roberto



Trushi,Frano Prenga,Albina Livadhi,Ervis Shimaj,Rita Preçi,Ermir Tahiri,Ornela Lleshi,Besmir Kapaj, ,Meliha Zyberaj,Edona Molla).

Z.Ervis Shimaj lexon piken e gjashtë të rendit të ditës:

Projekt vendim për dhënien në përdorim me afat deri në 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 5 ha "Për aerogjenerator (stacionet, objektet përkatëse etj) dhe 3.909 km rrugë për tu lidhur me sipërfaqen që do të jepet në përdorim, 6.709 km linja transmetimi të energjisë elektrike në ekonominë pyjore Gjader Mnelë"

Z.Ervis Shimaj sqaron këshilltarët se edhe për këtë projekt vendim është realizuar dëgjese publike me datë 27.08.2025 në fshatin Mnel e Madhe dhe se të pranishmit kanë shprehur dakortesi për projekt vendimin, dhe për të raportuar për projekt vendimin fton Z.Zeqir Ujka - përgjegjës i zyrës pyjeve Bashkia Vau Dejës, i cili raporton për këshilltarët se bazuar në Ligjin nr 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 9 pika 1.2 c, neni 54 pika e/l, neni 18, është kompetencë e Këshillit të Bashkisë miratimi i dhënies në përdorim të tretëve sipas legjislacionit në fuqi, të pasurive shtetërore në pronësi apo administrim të Bashkisë, por ky projekt vendim në ndryshim me dy projekt vendimet e mësipërme, përfshin edhe 6.709 km linja transmetimi të energjisë elektrike në ekonominë pyjore Gjader Mnelë"

-Sipërfaqja që do të jepet në përdorim është 5 ha "për aerogjeneratorë(stacionet,objektet përkatëse etj) dhe 3.909 km rrugë për tu lidhur me sipërfaqen që do të jepet në përdorim(qira),si dhe 6.709 km linje transmetimi të energjisë elektrike. Në funksion të sipërfaqes që merret në përdorim, sipas VKM nr.559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore"

Tëardhurat vjetore që përfiton Bashkia nga miratimi i projekt vendimeve është:

Për projekt vendimin e mësipërm të ardhurat vjetore janë : 979,085 (Nentëqind e shtatëdhjetë enente mijë e tre qind e tetë dhjetë e pesë) lekë në vit.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 17 vota Pro.zero vota kundër dhe 2(dy) vota abstenim(Gjon Marku dhe Florin Tanushi) Këshilltarët që votuan Pro piken e gjashtë të rendit të ditës:(Mark Bisha,Franga



Kola,Kastriot Shkjau,Leonora Prenga,Neki Kapllanaj,Majlinda Ndreca,Arsen Mehmeti,Roberto Trushi,Frano Prenga,Albina Livadhi,Ervis Shimaj,Rita Preçi,Ermir Tahiri,Ornela Lleshi,Besmir Kapaj, ,Meliha Zyberaj,Edona Molla).

Z.Ervis Shimaj lexon piken e shtatë të rendit të ditës:

Projekt vendim për dhënie pëlqimi "Për përcaktimin e vendit të groposjes së kafshëve të ngordhura në një pjesë të pasurisë nr.675, Zk nr.1100, në fshatin Barbullush me sipërfaqe 500m2,sipas plan rilevimit bashkëlidhur".

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Z.Sajmir Topalli – specialist mjedisi pranë zyres sektorit mjedisit, Bashkia Vau Dejës, i cili spjegon për këshilltarët se problemi me kafshët e ngordhura si pasojë e sëmundjeve të ndryshme infektive ose jo, mbetet mjaft shqetësues për përhapjen e sëmundjeve të ndryshme duke krijuar pasiguri shëndetësore tek konsumatorët dhe familjarët.

Për këtë qëllim, me urdhërin nr 387 datë 24.06.2025 të kryetarit të bashkisë "Për menaxhimin e situatës së prezencës së sëmundjes së murtajës në territorin e Bashkisë Vau Dejës", është ngritur grupi i punës me detyra të qarta ndërmjet të tjerave edhe për përcaktimin e vendit të groposjes së kafshëve të ngordhura si dhe hartimin e një plan veprimi për menaxhimin efektiv të kësaj situate.

Sipërfaqja e marrë në studim nga grupi i punës, objekt i këtij projekt vendimi, është pasuri e llojit SHESH, me sipërfaqe të përgjithshme prej 1370 m2, ndodhur në fshatin Barbullush, larg qendrave të banuara e cila sipas studimit tonë shërben mjaft mirë për qëllimin për të cilin kemi planifikuar projekt vendimin, "Për groposjen e kafshëve të ngordhura në territorin e bashkisë Vau Dejës".kjo sipërfaqe do vihet në dispozicion të qëllimit të përcaktuar, për të cilin kërkojmë miratimin nga ana juaj sipërfaqen prej 500 m2 në fshatin Barbullush, "Për groposjen e kafshëve të ngordhura në territorin e bashkisë Vau Dejës"

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 19 vota Pro.zero vota kundër dhe zero vota abstenim Këshilltarët që votuan **Pro** piken e shtatë të rendit të ditës:(Gjon Marku,Florin Tanushi,Mark Bisha,Franga Kola,Kastriot Shkjau,Leonora Prenga,Neki Kapllanaj,Majlinda Ndreca,Arsen Mehmeti,Roberto Trushi,Frano



Prenga, Albina Livadhi, Ervis Shimaj, Rita Preçi, Ermir Tahiri, Ornella Lleshi, Besmir Kapaj, Meliha Zyberaj, Edona Molla).

Z. Ervis Shimaj lexon piken e tetë të rendit të ditës:

Projekt vendim për rishikimin e Vkb nr.36 datë 26.06.2025 "Mbi dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjes të shtetasit Pjetër Mirash Gjoni i dëmtuar nga zjarri me datë 16.05.2025, banorë i Bashkisë Vau Dejës".

Z. Ervis Shimaj fton për të relatuar znj. Valjeta Nikaj-pergjegjese zyres emergjencave civile, Bashkia Vau Dejës, e cila shpjegon se Institucioni i Prefektit Qarkut Shkodër ka kërkuar, certifikatë pronësie ose statusin juridik të pronës së Z. Pjetër Mirash Gjoni e dëmtuar nga renia e zjarrit me datë 16.05.2025, zotëria ka aplikuar për statusin juridik të pronës pranë ASHK.

Z. Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z. Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 19 vota Pro, zero vota kundër dhe zero vota abstenim Këshilltarët që votuan **Pro** piken e tetë të rendit të ditës: (Gjon Marku, Florin Tanushi, Mark Bisha, Franga Kola, Kastriot Shkja, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Majlinda Ndreca, Arsen Mehmeti, Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi, Ervis Shimaj, Rita Preçi, Ermir Tahiri, Ornella Lleshi, Besmir Kapaj, Meliha Zyberaj, Edona Molla).

Z. Ervis Shimaj lexon piken e nëntë të rendit të ditës:

Projekt propozim për ndryshimin e emërimit të një segmenti të një rruge në lagjen Mllojë, Bashkia Vau Dejës, me emrin e propozuar "Zef Tanushi", lagja Mllojë, Bashkia Vau Dejës.

Z. Ervis Shimaj sqaron këshilltarët se për arsye shëndetësore, hartuesja e projekt vendimit nuk mund të jetë prezent por sqaron se sipas kërkesës së disa banorëve të lagjes Mllojë të cilet kërkojnë që një segmenti rrugor të vendoset emri "Zef Tanushi", për të cilin i është bërë edhe verifikimi i figurës dhe ka rezultuar figurë e pastër dhe për këtë arsye ju propozojmë miratimin e projekt vendimit.

Z. Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.



Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 19 vota Pro, zero vota kundër dhe zero vota abstenim Këshilltarët që votuan **Pro** piken e nëntë të rendit të ditës: (Gjon Marku, Florin Tanushi, Mark Bisha, Franga Kola, Kastriot Shkja, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Majlinda Ndreca, Arsen Mehmeti, Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi, Ervis Shimaj, Rita Preçi, Ermir Tahiri, Ornela Lleshi, Besmir Kapaj, Meliha Zyberaj, Edona Molla).

Z.Ervis Shimaj lexon piken e dhjetë të rendit të ditës:

Projekt vendim për miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis Nj.Q.V dhe K.M të R.Sh për rritjen e kapaciteteve të Q.V, akademia e trajnimit të Njësive të vetëqeverisjes vendore të Shqipërisë (TALGA)

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar znj. Marinela Deda- drejtore të zyrës juridike pranë Bashkisë Vau Dejës, e cila relatton për këshilltarët se kemi praqitur projekt vendimin për miratimin marrëveshjen për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta (SKP), në formën e organizatë jofitimprurëse me anëtarësi, midis njësive të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë, dhe anëtarësimin e Bashkisë Vau Dejës në SKP, të quajtur "Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)", bazuar në statutin dhe aktin e themelimit bashkëlidhur këtij vendimi". Të miratojë aktin e themelimit të TALGA-s dhe përfaqësimin e Bashkisë Vau Dejës në TALGA (SKP), sipas përcaktimeve të statutit të TALGA-s dhe të marrëveshjes.

Të miratojë efektet financiare të anëtarësimit të Bashkisë Vau Dejës si anëtare e TALGA (SKP) dhe detyrimin përkatës të pagesës vjetore të kuotës së anëtarësisë, nga fondi i parashikuar për trajnimet në buxhetin e vitit 2025 dhe në Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027, dhe në shumën e përlogaritur në përputhje me planin e financimit të përbashkët të Këshillit të Ministrave dhe të NJVV-të e tjera anëtare dhe vendimit përkatës së Asamblesë të Përgjithshme të TALGA. Efektet financiare për anëtarësimit dhe detyrimet e pagesave vjetore ndaj TALGA, për tri vitet e para e në vijim, do të përballohen nga të ardhurat e veta të bashkisë.



Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Vau Dejës të nënshkruaj marrëveshjen ndërmjet ministrit përgjegjës për çështjet vendore, i autorizuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 405 dt. 16.07.2025.

Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Vau Dejës të përfaqësojë Bashkinë Vau Dejës në organet vendimmarrëse, ekzekutive dhe organe të tjera të ngritura me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të TALGA.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 19 vota Pro, zero vota kundër dhe zero vota abstenim Këshilltarët që votuan **Pro** piken e dhjetë të rendit të ditës: (Gjon Marku, Florin Tanushi, Mark Bisha, Franga Kola, Kastriot Shkjau, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Majlinda Ndreca, Arsen Mehmeti, Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi, Ervis Shimaj, Rita Preçi, Ermir Tahiri, Ornela Lleshi, Besmir Kapaj, Meliha Zyberaj, Edona Molla).

Pika 11 Të ndryshme:

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët për pyetje apo shqetësime që kanë hasur në zonat e tyre, drejtuar Kryetarit Bashkisë i cili është prezent në mbledhje.

Te kjo pikë e rendit të ditës, rivjen në mbledhje këshilltari Z.Pjetër Lleshi.

Z.Gjon Marku: Meqenëse jemi në prag të hartimit të buxhetit të vitit të ardhshëm, kërkoj që të mendohet dhe të parashikohet për vitin e ardhshëm rikonstruksioni i Kinemasë në qytetin e Vau Dejës si dhe të parashikohen shtrim të disa rrugëve me asfalt në qytet.

Z.Kristian Shkreli-Kryetar Bashkie, përgjigjet: Para pak ditësh na është dhënë fjala nga Ministria e Kulturës për rikonstruksionin e i Kinemasë në qytetin e Vau Dejës gjithashtu lidhur me asfaltimet e disa rrugëve që ju përmendni, do ti parashikojmë në buxhetin e vitit 2026.

Z.Florin Tanushi propozon që të sistemohet qendra e qytetit të Laçit, pjesa e pedonales.

Z.Kristian Shkreli, përgjigjet: Me të vërtetë se pjesa e pedonales ka nevojë për nderhyrje por na ka dalë pengesë problemi i pronësisë me ish magazinat në qendër sepse projektin e kemi gadi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Mbledhjen e rradhës e datës 29.08.2025 deklarohet e mbyllur nga kryetari Këshillit pasi nuk kishte pyetje apo diskutime tjera.

Mbajtësi i Protokollit

Sekretari Këshillit

Ardian CELEPIA



Këshilltarët:

- | | |
|------------------------------|-----------------------------|
| 1. <u>Egris Shkurtaj</u> | 16. <u>Mustafë Shkurtaj</u> |
| 2. <u>Enxheta Kishaj</u> | 17. <u>Enxheta Kishaj</u> |
| 3. <u>Natë Cepkanaj</u> | 18. <u>Besmir Kogaj</u> |
| 4. <u>Melike Gjergj</u> | 19. <u>Anxheta Haxhiu</u> |
| 5. <u>Frono Pirogo</u> | 20. _____ |
| 6. <u>Osnela Lleshi</u> | 21. _____ |
| 7. <u>Majlinda Ndreci</u> | 22. _____ |
| 8. <u>Lezhana Prenpa</u> | 23. _____ |
| 9. <u>Rita Spasaj</u> | 24. _____ |
| 10. <u>Jon Jonashi</u> | 25. _____ |
| 11. <u>Pjeter Haxhiu</u> | 26. _____ |
| 12. <u>Robert Inalhi</u> | 27. _____ |
| 13. <u>Edona Molla</u> | 28. _____ |
| 14. <u>Allina Livilatshi</u> | 29. _____ |
| 15. <u>Mont Bish</u> | 30. _____ |
| | 31. _____ |